



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNITI I OBILIQIT - OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Dalës-lizano

Nr. 1-173
Br.

Data 14.11.2018
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 22.11.2018, (e enjte) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive "Adem Jashari" në Obiliq
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Obiliqit
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit

Burim Gërguri
Burim Gërguri



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT


Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.25.10.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë: Burim Gërguri, Florije Jashari, Linda Sadiku, Hysni Mjeku, Qëndresa Dubova, Armend Rushiti dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Ajet Berisha, Nënkryetar i Komunës, Përparim Klinaku, drejtor i administratës së përgjithshme, Zara Behluli, drejtoreshë e DFEZH, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Ibush Mjekiqi, drejtor i DSHMS-së, Burim Ismaili, drejtor i DI-së, Enver Grajqevci, drejtor i infrastrukturës lokale, Ferid Hashani, drejtor i bujqësisë

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE



1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së,
4. Zgjedhja e Kë shillave të fshatrave dhe Lagjeve Urbane sipas Rregullores nr.-I-48, të dt.30.04.2015
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Burim Gërguri – Fillimisht ju njoftoj se çështja e përkthimit është rregullue dhe tash mund të punojmë më lehtë. Tani, ju njoftoj me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës, i cekur më lartë.

1.Pika e parë e rendit të ditës –

Të gjithë anëtarët e KPF-së, ishin të pranishëm.

2.Pika e dytë e rendit të ditës –

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Linda Sadiku, e lëshoi mbledhjen me arsye.

3.Pika e tretë e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Juve, ju ka ardhë kërkesa e DKRS-së, dhe ka qenë propozimi i DKRS-së, ndaj Kryetarit të Komunës, i cili pastaj na është drejtuar me një propozim. Këtu, fjala është për dhënien në shfrytëzim të Shtëpisë së Kulturës, e cila gjendet në Milloshevë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesa e DKRS-së, (e Kryetarit të Komunës), kërkesa me nr.1-24601/2018, e dt.13.09.2018.

4.Pika e katërt e rendit të ditës -

Burim Gërguri – Ju e dini se Këshillat e fshatrave janë formuar në vitin 2015, me mandat 3 vjeçar dhe tash mandati ju ka skadue. Ne në mbledhjen e Kuvendit komunal duhet ti formojmë 2 Komisione, për përzgjedhjen e Këshillave Lokale dhe Lagjeve Urbane në bazë të Rregullores në fuqi.

Ajet Berisha – Kuvendi Komunal vendosë për këtë çështje dhe aty nga përvoja ku kemi probleme është mirë me bë ndarje të fshatrave, meq ë tash kemi mundësi buxhetore më të madhe nëse secili fshat duhet me pasë Këshillin e vet, le ta ketë.

Burim Gërguri - Në atë kohë është bërë një punë e jashtëzakonshme, por duke i ditur problemet që kanë qenë atëherë janë fuzionue 3 fshatra, në një dhe tani e tutje ne po bëjmë përpjekje që mos ti kemi këto probleme. Poashtu, Kryetari i Këshillit të fshatit ka të drejtë të paguhet sipas Rregullores, por edhe anëtarët e

Komisionit do të paguhen. Pra, Kuvendi vendosë për rritjen e numrit të Këshillave të fshatrave dhe për pagesën e anëtarëve të Komisioneve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim:

- a) **Formimi i Komisioneve komunale për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve Urbane sipas Rregullores nr.I-48, të dt.30.04.2015**
- b) **Shqyrtimi i propozimeve për rritjen e numrit të Këshillave të fshatrave dhe Lagjeve urbane**
- c) **Shqyrtimi i propozimit për kompensim të anëtarëve të Komisioneve.**

5.Pika e pestë e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Lexon kërkesën nga DPUKP, për rrënimin e objektit të Komunës së vjetër për shkak të ndërtimit të sheshit të qytetit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesa e DPUKP-së për rrënimin e objektit të Komunës së vjetër.

Burim Gërguri – Lexon kërkesën e Këshillit të fshatit Plemetin, lidhur me investimet e kërkuara, por kjo kërkesë meqë ka ardhë pas datës së mbledhjes i shkon Kryetarit të Komunës për shqyrtim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

Kërkesa e Këshillit të fshatit Plemetin, nga Jakovljevic Nebojsa i dërgohet Kryetarit të Komunës për trajtim të investimeve kapitale për vitin 2019.

Burim Gërguri – Lexon kërkesën nga OJQ, “Zëri i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve”.

Ajet Berisha – Drejtorja e Arsimit, është mirë me na sqarue në Kuvend se çka duhet të bëjmë më tutje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

Kërkesa nga OJQ “Zëri i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve” i dërgohet Drejtorisë së Arsimit për shqyrtim me obligimin që të vijë me sqarim në Kuvend .

Burim Gërguri – Lexon kërkesën nga Xhavit Krasniqi, nga fshati Breznicë i cili kërkon mjete për ndërtimin e një ndërtese për pastrimin e kufomave dhe pritjen e pamjeve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

Kërkesa nga Xhavit Krasniqi, nga fshati Breznicë i dërgohet Kryetarit të Komunës për shqyrtim.

Burim Gërguri – Lexon kërkesën nga komuniteti i fshatarëve Grabofci i Epërm dhe Shipitullë, të cilët nuk janë të kënaqur me investimet komunale dhe kërkojnë të investohet në trotuar, rrugë, kanalizim etj.

Ajet Berisha – Kjo kërkesë është mirë ti shkoj Kryetarit të Komunës, sepse ne kemi ndarë disa vija, por nuk kemi emëruar rrugë ose projekte konkrete. Prandaj, në kuadër të vitit 2019, Kryetari aq sa ka mundësi me i buxhetue dhe me i përfshi pjesët e investimeve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

Kërkesa nga komuniteti i Grabofcit të Epërm dhe Shipitullës, i dërgohet Kryetarit të Komunës për shqyrtim.

Burim Gërguri – Raporti 9 mujor i Kryetarit të Komunës, ka ardhë si kërkesë dhe e ftoj drejtoreshën të na jepë sqarime rreth këtij raporti.

Zarife Behluli – Unë e kam paraqitë buxhetin fillestar dhe shpenzimet e buxhetit për vitin 2018 – 30 shtator 2018. Buxheti me paga, grant me të hyra vetanake dhe të bartura është 2 milion e 891,643.01, dhe shpenzim është e njejta vlerë, ndërsa mjete të lira janë prej fondit 21 dhe fondit 22. Mallra dhe shërbime janë 469,954.61 €, shpenzim janë 274,482.26€, zotim janë 98,079.03 €, të lira janë 97,393.32 €. Kjo është gjendja me dt.30.09, por këto tash nuk janë të njejta. Shpenzime komunale, grand të hyra dhe të bartura janë

122,816.78 €, shpenzim janë 103,346.73 €, zotim janë 2,550.81 €, dhe të lira janë 16,919.24 €. Subvencione dhe transfere janë 134,943.92 €, shpenzim janë 77,775 €, në zotim janë 16,155 €, të lira janë 41,013.92 €. Këtu, bëhet fjalë për Zyren e Kryetarit, DSHMS, DKA dhe Drejtorinë e bujqësisë. Shpenzimet kapitale janë 2,376,870.22 €, të shpenzuara janë 346,680.47 €, ndërsa në zotim janë 1,702,427.23 €. Të lira në atë periudhë kanë qenë 327,762.52. Buxheti në total është 6 milion e 61,349.94. Në total shpenzim këtu, janë 5 kategoritë ekonomike 3,772,724.14 €, të zotimit janë 1,827,552.11 €, dhe të lira 511,073.69 €.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim Raporti financiar 9 mujour (Raporti i DEFZH).

Burim Gërguri – Lexon kërkesën e Kryetarit të Komunës, për emërimin e sheshit të qytetit me emrin “Adem Preniqi”.

Armend Rushiti – Sa i përket emërimit të sheshit me emrin e veprimtarit z:Adem Preniqi” unë mendoj se ka edhe propozime tjera, por për këtë do të flasim në mbledhjen e Kuvendit komunal.

Hysni Mjeku – Propozoj që kjo kërkesë të shkoj në Kuvendin Komunal sepse mund të ketë edhe propozime tjera.

Burim Gërguri - Unë uroj Ekzekutivin komunal, në krye me Kryetarin e Komunës, për projektin më të madh që ndonjëherë ka ndodhë në Komunën e Obiliqit “Ndërtimi i sheshit të qytetit”. Poashtu, e falenderoj Kryeministrin dhe ministrin e infrastrukturës, ku atë ditë një pjesë e asambleistëve ka qenë prezentë, ndërsa pjesa tjetër s’ka ardhë. Sa i përket emërimit të sheshit do të vendoset në mbledhjen e Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota “Për” dhe 1 votë “Kundër” morën këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesa e Kryetarit të Komunës, për emërimin e sheshit të qytetit me emrin “Adem Preniqi”.

Burim Gërguri – Lexon kërkesën nga Basri Statovci, pronar i sh.p.k. “Bas Trade” i cili kërkon ti mundësohet pjesa e pagesës dhe të pajiset me leje ndërtimore. Këtu, bëhet fjalë për 8 vite, pas lejes që është lëshuar dhe nuk e di kur ka marrë përgjegje nga DPUK, por ju e dini se Kuvendi komunal nuk lëshon leje, as Këshilli i drejtorëve nuk lëshon leje. Në bazë të ligjit, Udhëzimeve dhe planit urbanistik lejet lëshohen nga DPUKP.

Hysni Mjeku – Pyet pse nuk është dhënë leja deri tash sepse qe 8 vjet është neglizhue kjo çështje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

REKOMANDIM

Kjo kërkesë i dërgohet DPUKP-së, për shqyrtim me obligimin që të sjellin një sqarim rreth kësaj kërkesë në mbledhjen e Kuvendit komunal.

Mbledhja përfundoi në ora 10:40’

Bashk.prof.për punë të KK-së

Azize Zeneli

Kryesuesi i KPF-së

Burim Gërguri

